



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.202/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Afijete Sada Gillogjani dhe Adnan Konushevi anëtar, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 17.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Hidhen si të pas afatshme ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ZL.A.nr.202/2017, ZL.A.nr.203/2017, ZL.A.nr.204/2017, ZL.A.nr.205/2017, ZL.A.nr.206/2017, ZL.A.nr.207/2017, ZL.A.nr.208/2017, të paraqitura me datë 12.10.2017, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët.

A r s y e t i m

Me datën 12.10.2017, PZAP-i ka pranuar shtatë ankesa: A.nr 202/2017, A.nr. 203/2017, A.nr. 204/2017, A.nr. 205/2017, A.nr. 206/2017, A.nr.207/2017 dhe A.nr. 208/2017 nga subjekti politik LVV, me të cilat pretendon se aktivistët e tyre kanë vërejtur, se në Fushë Kosovë dhe në Matiqan, në vende publike ishin vendosur njoftime për mbajtjen e tubimit të subjektit politik LDK. Me këtë rast parashtresë i ankesave thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 33 paragrafi 1, pika b), të LZP-së Ligji Nr. 03/L-073, nenit 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së, për faktin se njoftimet për tubime, janë vendosur në hapësira publike.

Paneli i PZAP -it, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartcekura dhe i trajton si një ankesë evidentuar me ZL.Anr.202/2017, për shkak të ekonomizimit të procedurës, pasi kemi të bëjmë me karakterin e njëjtë të rasteve (formati A5 i njoftimit), ndaj të njëjtit subjekt politik dhe pretendimeve të njëjta ankimore.

Paneli pas shqyrtimit dhe hetimit të të gjitha dëshmive relevante gjeti se:

Ankesat janë të pasafatshme.

Paneli pas shqyrtimit paraprak të ankesave, ka gjetur se ankesat e parashtruara nga subjekti politik LVV, kundër subjekti politik LDK, janë parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën 5.5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ku përcaktohet: “Për të gjitha çështjet që nuk lidhen drejtë për drejtë me votimin dhe numërimin, ankesa duhet të parashtrohet pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orëve nga shkelja e supozuar”. Ngase prej shkresave të lëndës del se shkeljet e pretenduara nga subjekti politik LVV, janë bërë me 10.10.2017 rreth orës 13:45 – 19:00. Afati për ankesa ka qenë 24 orë nga shkelja e supozuar. Ankesat në PZAP nga subjekti politik LVV, janë paraqitur me datë 12.10.2017, çka do të thotë 1 (një) ditë pas afatit të përcaktuar në dispozitën e nenit 5.5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-së.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së dhe nenin 5 par.5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.A.nr. 202/2017 më datën 17.10.2017



Kryesuesja e Panelit

Gyltene Sylejmani

Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.